



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 12/2019) nenit 40 dhe nenit 41 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK), duke vepruar pas denoncimit anonim, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK), në seancës së 46-të të mbajtur me datë 12 shkurt 2021, KSHPK morri

VENDIM

Procedura për lëndën nr. 12-3487 nga viti 2019 e formuar pas denoncimit anonim me nr. 12-3487/1 me datë 10.08.2019 dorëzuar nga ish i punësuar në SHA - nga, **NDËRPRITET.**

Në përputhje me dispozitat e Ligjin për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm kompetent në lëndën me numër 12-3487 nga viti 2019, në rastin e lëndës vepron organ tjetër kompetent.

Lënda me numër 12-3487 nga viti 2019 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, me sqarimin, në formë të depersonalizuar, të publikohet në web-faqen e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes së vendimit.

SQARIM

Lënda me numër 12-3487 nga viti 2019 është formuar në bazë të denoncimit anonim me nr. 12-3487/1 me datë 10.08.2019, dorëzuar deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nga ish i punësuar në SHA - nga

Në denoncimin e dorëzuar flitet për akuza për punë joligjore të ndërmarrjes SHA - nga, në lidhje me disponim e pronës joligjore në pronësi të kësaj ndërmarrje dhe punë joligjore të menaxhuesi të kësaj ndërmarrje, personit nga fshati

Pas rishikimit të rastit të lëndës, KSHPK i merr parasyshtë akuzat e parashtruesit dhe në drejtim të caktimit të gjendjes faktike, dorëzoi kërkesë deri tek Drejtoria e të ardhurave publike për informacione dhe të dhëna në lidhje me rastin e lëndës. Pas kërkesës së Komisionit shtetëror është dorëzuar informim me informacionet e kërkuara me shtojcë dokumentacion dhe pas rishikimit të dokumentacionit të plotë me të cilën disponon për rastin e lëndës, nga ana e KSHPK është caktuar gjendja faktike vijuese:

- Në denoncim flitet se ndërmarrja e përmendur disponon me prone të madhe në, (shtëpi mallrash, dy shitore, shitore nr. – dhe shitore nr-, tre magazina nr. -, nr. – dhe nr.-) dhe të cilën pronë nga ana e subjektit juridik të përmendur është dhënë me qira, mirëpo nuk janë paraqitur të ardhurat nga qiraja, nuk është paguar tatimi, dhe gjithashtu nuk e di sa dhe si nga prona e përmendur është shitur. Në denoncimin e dorëzuar flitet se për ndërmarrjen e përmendur është zhvilluar procedura e falimentimit në të cilën për menaxhues falimentimi është emëruar personi, dhe pastaj si drejtor i të njëjtës është caktuar personi i punësuar si kontrollor, i cili pasi u emërua si drejtor i SHA - në fillim ka filluar të punon mirë, i ka dhënë me qira objektet, shitoret, shtëpinë e mallrave, ka punur

me dhe ka paguar tatim, mirëpo pastaj një nga një punëtorët i ka pushuar nga puna, nuk i ka paraqitur të ardhurat dhe nuk ka paguar tatim. Për parregullsitë e kryera personi i përmendur është denoncuar në Drejtorinë e të ardhurave publike mirëpo, sipas parashtruesit të denoncimit ndokush e ka mbrojtur për 25 vite, personave që i kanë ndihmuar iu ka dhënë shpërblime nga ndërmarrja, mirëpo nuk i ka shpërblyer personat që kanë luftua për atë (për ndërmarrjen).

Parashtruesi kërkon nga KSHPK ta kontrollojë rastin e lëndës në lidhje me atë se vallë ndërmarrja e përmendur ekziston ende dhe në çfarë gjendje është, gjithashtu kërkon të dërgohen inspektorë që të shohën se çka posedon personi nga fshati

Pas bërjes së kontrollimeve nga ana KSHPK erdhi deri tek këto njohuri:

- Nga të dhënat e publikuara në web faqen e Drejtorisë për të ardhura publike dhe Regjistrin qendror, është konstatuar se subjekti juridik i përmendur është i evidentuar si Shoqëri aksionare për tregëti dhe prodhim të materialeve ndërtimore, materiale të prera dhe produkte finale të drurit import-eksport, i njëjtë është themeluar me datë 23.09.1961 dhe në evidencën e Regjistrin qendror të RMV ka status juridik si subjekt aktiv në pronësi private, kurse si person i autorizuar dhe kryetarë i bordit drejtues është regjistruar personi Të dhënat e përmendura gjenden edhe gjendjen rrjedhëse për këtë subjekt të cilin KSHPK e siguroi nga evidenca elektronike në Regjistrin qendror të RMV me datë 28.10.2020.
- Në gazetën zyrtare numër 25 me datë 23.05.1996 në pjesën për shpallje është publikuar kjo: "Gjykata ekonomike e qarkut në Shkup me vendim St. Nr me datë 25. IV.1996 shpalli se obligoget barazi e detyruar të debitor të falimentimit SHA në falimentim dhe debitorët e tij me përmbajtjen e këtillë: Debitori i falimentimit SHA është obliguar t'i paguan detyrimet ndaj kreditorëve në vlerë prej 100% me interes sipas Ligjit në afat prej gjashtë muaj duke llogaritur nga miratimi i barazimit të detyruar. Ky barazim ka veprim juridik dhe ndaj kreditorëve të debitorit të falimentimit kërkesat e të cilit kan arritur në pagesë deri me datë 25.IV.1996 edhe pse nuk ka marrë pjesë në procedurën për barazim të detyruar si dhe ndaj kreditorëve të cilët kan marrë pjesë në procedurën, kërkesat e të cilit janë të diskutueshme nëse më vonë nuk vërtetohen. Ky vendim ka vlerë të dokumentit për zbatim ndaj të gjithë kreditorëve kërkesat e të cilëve janë vërtetuar në procedurën për barazim. Çdo pjesëmarrës në procedurën për barazim të detyruar i mbanë shpenzimet e veta. Ndërpritet procedura e falimentimit ndaj debitorit të falimentimit SHA, e nisur me vendim të kësaj Gjykate St.nr. Me datë 17.V.1995, për u.d. drejtor të SHA caktohet personi nga – gga Gjykata e ekonomike e qarkut në Shkup."
- Në web-faqen e Bursë së Maqedonisë me 09.03.2018 janë publikuar të dhëna nga raportet finansiare dhe dividenda të SHA, kurse në dokumentin e publikuar me të dhënat finansiare nga puna e kësaj SHA për vitin 2017, si menaxhues është nënshkruar personi
- Në web faqen e Ministrisë së finansave, është publikuar se Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut është themelues i 14 ndërmarrjeve publike dhe aksionar i vetëm në

15 shoqëri tregtare nga të cilat 13 janë shoqëri aksionare në pronësi të shtetit, kurse 2 janë SHAPKNJP në pronësi shtetërore. Në listën e publikuar në pjesën e "të dhëna financiare për vitin 2020" për ndërmarrjet publike dhe shoqëritë tregtare në pronësi shtetërore, nuk figuron SHA nga, që nënkupton se kjo shoqëri është shoqëri në pronësi private.

- Me datë 23.11.2020, pas kërkesës së KSHPK, është dorëzuar informim nga Drejtoria e të ardhurave publike – Drejtoria e përgjithshme në Shkup – Inspektorati i përgjithshëm tatimor, në të cilën informohet se nga ana e Drejtorisë për të ardhura publike është vepruar për kërkesën e KSHPK dhe se tek tatimpaguesi "....." është rekomanduar kontroll i jashtëm i tatimit të të ardhurave të përgjithshme për periudhën prej 01.01.2016 deri në 31.12.2019, me qëllim të kontrollimit edhe të informacioneve të theksuara në denoncimin e dorëzuar deri tek KSHPK, e cila kontrollë ende është në rrjedhë.

Në bazë të kësaj gjendje faktike të caktuar, KSHPK konstaton se në lidhje me akuzat nga rasti i lëndës është vepruar pas kërkesës së KSHPK dhe tek subjekti juridik i lëndës është filluar procedurë para organi tjetër kompetent – Inspektorati i përgjithshëm tatimor pranë Drejtorisë së të ardhurave publike në drejtim të kontrollit të jashtëm të tatimit të të ardhurave të përgjithshme për periudhën prej 01.01.2016 deri 31.12.2019, dhe para të cilit është filluar procedura ende është në rrjedhë dhe kontrolli ende nuk është mbaruar. Duke pas parasysh të konstatuarën, KSHPK vlerëson se nuk ka elemente për veprim të tij të mëtutjeshëm në lëndën e rastit, procedura për lëndën të ndërpritet, kurse lënda të mbyllet dhe të arkivohet

Në bazë të tërë kësaj të shënuar më sipër, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vendosi sipas dispozitave të këtij vendimi.

Është vendosur me datë 12 shkurt të viti 2021 me numër 12-358/3

Dorëzuar deri tek: Arkiva

Pas përfundimit të KSHPK

Përpunoi: J. C., këshilltarë

Miratoi: G. T., anëtar i KSHPK

**KOMISIONI SHTETËROР ПЉР
PARANDALIM TË KORRUPSIONIT
Kryetarë: Biljana Ivanovska**